



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.17

3 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.68, datë 12.2.2010	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	521
Vendim i KM nr.70, datë 19.2.2010	Për lejimin e kalimit tranzit të disa autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	521
Vendim i KM nr.79, datë 10.2.2010	Për lejimin e kalimit tranzit të një autokolone ushtarake italiane përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	522
Vendim i KM nr.80, datë 10.2.2010	Për ndryshimin e përgjegjësive së administrimit të disa mjediseve, nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të pronave.....	523
Vendim i KM nr.86, datë 10.2.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Treska 3”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	525
Vendim i KM nr.87, datë 10.2.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Çerkezë 1” dhe “Çerkezë 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	525
Vendim i KM nr.88, datë 10.2.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.429, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Masave për Importet”.....	526
Vendim i KM nr.89, datë 10.2.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë shkollës së lartë private “Ufo University”, Tiranë.....	526

Vendim i KM nr.90, datë 10.2.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private “Epoka”, Tiranë.....	527
Vendim i KM nr.97, datë 24.2.2010	Për ngritjen e Komitetit Ndërministror të Emergjencës Civile, për përballimin e situatës së krijuar, si pasojë e kushteve të rënduara atmosferike.....	528
Vendim i GJK nr.2, datë 3.2.2010	Me objekt shfuqizimin e paragrafit të fundit të nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	529
Vendim i GJK nr.3, datë 5.2.2010	Me objekt: 1. Shfuqizimin e ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, si i papajtueshëm me Kushtetutën. 2. Pezullimin e ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. 3. Papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001.....	533
Vendim i GJK nr.4, datë 12.2.2010	Me objekt shfuqizimin e ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, si antikushtetues.....	542

VENDIM
Nr.68, datë 12.2.2010

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 10 (dhjetë) automjete dhe 23 (njëzet e tre) trupa të armatosura, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 13 shkurt 2010.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 11 (njëmbëdhjetë) trupa të armatosura, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 15 shkurt 2010.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake italiane, e cila do të kalojë tranzit në datën 13 shkurt 2010, të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake italiane, e cila do të kalojë tranzit në datën 15 shkurt 2010, të jetë pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Autokolona ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.70, datë 19.2.2010

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE
SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 21 shkurt 2010, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit të 2 (dy) autokolonave ushtarake sllovene, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë nga 3 (tre) mjete dhe 6 (gjashtë) trupa të armatosura.

- Autokolona e dytë nga 6 (gjashtë) mjete dhe 13 (trembëdhjetë) trupa të armatosura.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për 2 (dy) autokolonat ushtarake sllovene, që do të kalojnë tranzit në datën 21 shkurt 2010, të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë porti i Durrësit.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 22 shkurt 2010, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, të 5 (pesë) autokolonave ushtarake sllovene, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë nga 1 (një) mjet dhe 2 (dy) trupa të armatosura.
- Autokolona e dytë nga 1 (një) mjet dhe 2 (dy) trupa të armatosura.
- Autokolona e tretë nga 20 (njëzet) mjete edhe 40 (dyzet) trupa të armatosura.
- Autokolona e katërt nga 1 (një) mjet dhe 2 (dy) trupa të armatosura.
- Autokolona e pestë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) mjete dhe 38 (tridhjetë e tetë) trupa të armatosura.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për 5 (pesë) autokolonat ushtarake sllovene, që do të kalojnë tranzit në datën 22 shkurt 2010, të jetë porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 25 shkurt 2010, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, të 2 (dy) autokolonave ushtarake sllovene, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë nga 1 (një) mjet dhe 2 (dy) trupa të armatosura.
- Autokolona e dytë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) mjete dhe 41 (dyzet e një) trupa të armatosura.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për 2 (dy) autokolonat ushtarake sllovene, që do të kalojnë tranzit në datën 25 shkurt 2010, të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë porti i Durrësit.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 25 shkurt 2010, në itinerarin porti i Durrësit –Qafë-Thanë, të 1 (një) autokolone ushtarake sllovene, të përbërë nga 4 (katër) mjete dhe 8 (tetë) trupa të armatosura.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake sllovene, që do të kalojë tranzit në datën 25 shkurt 2010, të jetë porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Autokolona ushtarake sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.79, datë 10.2.2010

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOKOLONE USHTARAKE ITALIANE
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokolone

ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa të armatosura, në datën 10 shkurt 2010, në itinerarin porti i Durrësit – Qafë - Thanë.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake italiane është porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Autokolona ushtarake italiane gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.80, datë 10.2.2010

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE, NGA INSTITUTI I STUDIMEVE TË TEKNOLOGJISË SË NDËRTIMIT, AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve, përkatësisht, kati i parë teknik dhe kati i dytë teknik të ndërtesës së Institutit të Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit, nga ky institut, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.86, datë 10.2.2010

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “TRESKA 3”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Treska 3”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Zecoronda”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Treska 3”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.87, datë 10.2.2010

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “ÇERKEZË 1” DHE “ÇERKEZË 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Çerkezë 1” dhe “Çerkezë 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Zall Herr Energi”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Çerkezë 1” dhe “Çerkezë 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.88, datë 10.2.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.429, DATË 8.4.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E
MASAVE PËR IMPORTET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.429, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) “z.Genc Ruli zëvendësohet me z.Dritan Prifti, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”;

b) “znj.Lindita Xhillari zëvendësohet me z.Agron Shehaj, drejtor i departamentit juridik dhe shërbimeve, në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.89, datë 10.2.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PRANË SHKOLLËS SË LARTË
PRIVATE “UFO UNIVERSITY”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i nivelit të parë”, MNP, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Pedagogji” me këto profile:

a) “Didaktikë” ;

b) “Menaxhim arsimit”.

2. Ky program studimi, i ciklit të dytë, realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma:

- a) “Master i nivelit të parë, në pedagogji”, (MNP), me profil didaktikë;
- b) “Master i nivelit të parë, në pedagogji”, (MNP), me profil menaxhim arsimit.
3. Hapjen në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, (MND), në formën e studimeve me kohë të plotë, në:
- a) “Psikologji klinike”;
- b) “Politikë e jashtme dhe diplomaci”;
- c) “Pushtet ekzekutiv”;
- ç) “Shkenca administrative”;
- d) “Marrëdhënie ndërkombëtare”;
- dh) “Kontratat dhe e drejta europiane”;
- e) “E drejta tregtare ndërkombëtare”;
- ë) “Gazetari globale”.
4. Këto programe studimi, të ciklit të tretë, realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma:
- a) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në psikologji klinike;
- b) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në politikë e jashtme dhe diplomaci;
- c) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në pushtet ekzekutiv;
- ç) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në shkenca administrative;
- d) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në marrëdhënie ndërkombëtare;
- dh) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në kontratat dhe e drejta europiane;
- e) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në e drejta tregtare ndërkombëtare;
- ë) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në gazetari globale.
3. Shkolla e lartë private “UFO University”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.
4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.90, datë 10.2.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË
LARTË PRIVATE “EPOKA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Epoka”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Inxhinieri ndërtimi” me profilet:
- a) “Inxhinieri e strukturave të ndërtimit”;
- b) “Menaxhim i ndërtimeve”.
2. Ky program studimi i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në “Inxhinieri ndërtimi” me profilet:

a) “Inxhinieri e strukturave të ndërtimit”;
b) “Menaxhim i ndërtimeve”.

3. Hapjen në shkollën e lartë private “Epoka”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë (MND)”, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Inxhinieri ndërtimi”.

4. Ky program studimi i ciklit të tretë realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë (MND), në inxhinieri ndërtimi”.

5. Shkolla e lartë private “Epoka”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.97, datë 24.2.2010

PËR NGRITJEN E KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCËS CIVILE PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR, SI PASOJË E KUSHTEVE TË RËNDUARA ATMOSFERIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencës Civile, për përballimin e situatës së krijuar, si pasojë e kushteve të rënduara nga moti i keq, i vazhdueshëm.

2. Ky Komiteti të kryesohet nga Ministri i Brendshëm dhe në përbërje të tij të ketë:

- Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohet Komiteti Ndërmintor i Emergjencës Civile për hartimin e menjëhershëm të një plani masash për përballimin e kësaj situatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.2, datë 3.2.2010

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 14.7.2009, mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen me nr.12/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Apelit Shkodër.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Lulzim Lelçaj.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Marsida Xhaferllari.

Ministria e Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i paragrafit të fundit të nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.2598, datë 12.11.2007, ka njohur paditësin E.M. pronar të një ndërtese 50.5 m² dhe truallit 202 m² me parashkrim fitues. Kjo gjykatë ka vendosur edhe detyrimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për të bërë ndryshimet në regjistrat përkatës.

Me vendimin nr.13, datë 9.4.2008, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) ka refuzuar regjistrimin e pasurisë dhe ia ka kaluar praktikën për kompetencë Kryeregjistruesit. Ky i fundit, me urdhrin nr.464, datë 13.05.2008, ka refuzuar kërkesën për regjistrimin e vendimit nr.2598, datë 12.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Shtetasi E.M. ka paditur ZVRPP Shkodër për refuzimin e regjistrimit të vendimit gjyqësor nr.2598, datë 12.11.2007.

Me vendimin nr.1559, datë 30.05.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë me objekt: “...anulimin e aktit administrativ të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme nr.13, datë 09.04.2008 dhe detyrimin e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) për të nxjerrë një akt administrativ në përputhje me ligjin, duke marrë masat për vendosjen e të drejtës së cenuar të paditësit”. Kundër këtij vendimi paditësi është ankuar në gjykatën e apelit.

Gjykata e Apelit Shkodër, më datë 19.11.2008, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative me nr.1559 të vendimit, datë 30.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Apelit Shkodër i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të shfuqizojë si të papajftshme me Kushtetutën fjalinë e fundit të nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007. Kjo dispozitë ka këtë përmbajtje: *“Elementet e vendimit që verifikohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedura e nxjerrjes së urdhrin, përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave”*.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e paragrafit të fundit të nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007:

- Kompetenca që i jepet regjistruarit për të verifikuar elementet e vendimit të formës së prerë bie ndesh me parimin e balancimit dhe ndarjes së pushteteve, garantuar nga neni 7 i Kushtetutës dhe, e vendos pushtetin gjyqësor nën kontrollin e pushtetit ekzekutiv;

- Nëse një vendim i formës së prerë, dhënë nga gjykata, vihet në diskutim nga një organ administrativ, parimi i sigurisë juridike cenohet dhe individit nuk ka asnjë garanci për zgjidhjen e çështjes në rrugë gjyqësore.

Këshilli i Ministrave ka parashtruar këto argumente për të kundërshtuar kërkesën:

- Sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë mes ligjit të kundërshtuar për antikushtetutshmëri dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në rastin në shqyrtimit, kjo lidhje nuk ekziston, sepse gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër kanë pasur mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim;

- Çështja e referuar pranë Gjykatës Kushtetuese është përtej kufijve kushtetues të gjyqtarit të zakonshëm dhe priret drejt vlerësimit të vullnetit të Kuvendit nga pikëpamja e oportunitetit politik për rregullimin e çështjeve të caktuara shtetërore;

- Gjykata, në vendimin e pezullimit, nuk përcakton se cili është neni kushtetues apo parimi me të cilit bie ndesh parashikimi i ligjit (neni 37);

- Pretendimi për cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk ka lidhje me faktet dhe argumentet e paraqitura nga gjykata. Në asnjë fjalë të tij, neni 37 i ligjit nr.9701 nuk i jep zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme funksione gjyqësore;

- Procesi i verifikimit të elementeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, por përkundrazi, e vë atë në jetë;

- Paragrafi i fundit i nenit 37 të ligjit nr.9701 nuk ka defekte kushtetuese dhe është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 100 dhe 118 të Kushtetutës.

Kuvendi i Shqipërisë, si palë e interesuar, i është bashkuar pretendimeve të pakicës në vendimin e pezullimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe ka kërkuar rrëzimin e kërkesës.

II

Kërkuesi ka parashtruar se paragrafi i fundit i nenit 37 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr.9701, datë 2.4.2007, “...bie në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe parimin e sigurisë juridike. Përmbajtja e paragrafit të fundit të nenit të sipërpërmendur është: *“Elementet e vendimit që verifikohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedura e nxjerrjes së urdhrin, përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave”*.

Neni 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i njej të drejtën gjyqtarëve që, në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve, që për iniciues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm.

Në zbatim të dispozitës kushtetuese të përmendur më sipër, ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji i 530

Gjykatës Kushtetuese), në nenin 68, përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata ose gjyqtari për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese. Së pari, gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur, gjatë jurisprudencës së saj, se gjykata ose gjyqtari duhet të sqarojë me kujdes lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Evidentimi i kësaj lidhjeje është i domosdoshëm në kuptim të nenit 68 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (*Shih vendimin nr.5, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Duke insistuar në këtë kërkesë, kjo Gjykatë, në një vendim tjetër, është shprehur: "... Para marrjes së vendimit të pezullimit gjyqtari apo gjykata duhet të kenë parasysh që gjykimi që ata kanë nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra, gjyqtari duhet të krijojë mendimin se ligji që ai vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërt, nëse gjyqtari vlerëson se një ligj që sipas tij është antikushtetues nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes, ai duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes. Në mënyrë që të ekzistojë lidhja e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata, subjekt iniciues i gjykimit incidental, në kuptimin, që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese" (*Shih vendimin nr.13, datë 4.5.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në çështjen konkrete, Gjykata e Apelit Shkodër, më datë 19.11.2008, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes administrative me nr.1559, datë 30.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjykatë, në vendimin e pezullimit, ndër të tjera, ka çmuar se neni 37 i ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar me Ligjin nr.9701, datë 2.4.2007 "...që bën të mundur verifikimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, bie ndesh me parimin kushtetues të sigurtisë juridike, që është një ndër parimet e shtetit të së drejtës, për ndërtimin e të cilit bëhet fjalë në preambulën e Kushtetutës".

Gjykata vëren se neni 37 i ligjit nr.9701 është një normë deleguese, e cila i jep Këshillit të Ministrave të drejtën të përcaktojë me udhëzim elementet e vendimit gjyqësor që verifikohen nga ZRPP. Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka arritur të argumentojë, së pari, lidhjen e drejtpërdrejtë që ekziston ndërmjet kësaj dispozite ligjore dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në arsyetimin e saj kjo gjykatë nuk i përgjigjet pyetjes se pse ajo pengohet nga dispozita objekt shqyrtimi për t'i dhënë zgjidhje çështjes.

Gjykata e apelit i ka shtruar vetes pyetjen nëse mund ta shqyrtojë "...mosmarrëveshjen në fjalë kur ndodhet para një vendimi të formës së prerë, të detyrueshëm edhe për të, dhe nga ana tjetër një vendim administrativ të regjistruarit të bazuar në ligj". Nëpërmjet shtrimit të kësaj pyetjeje Gjykata e Apelit ka lënë të kuptohet se ndodhet përpara një konflikti midis neneve 193/h të Kodit Civil, 451/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 37 të ligjit objekt shqyrtimi. Gjykata Kushtetuese, ashtu sikundër është shprehur edhe më parë gjatë jurisprudencës së saj, vlerëson se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin e Gjykatës hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën. Mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*Shih vendimet nr.11, datë 27.5.2004 dhe nr.35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata e apelit arsyeton, ndër të tjera, se ajo ndodhet para dy akteve kontradiktore për zbatim, nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe pikës 2 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 31.1.2007, i dalë në mbështetje të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, ku punonjësit të ZRPP-së i jepet e drejta e verifikimit të elementeve të formës dhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore. Gjykata e apelit, nëpërmjet këtij arsyetimi, siç u përmend dhe më sipër, nuk

ka arritur të përmbushë detyrimin për përcaktimin e ligjit/aktit ku kjo gjykatë është e detyruar të mbështetet për zgjidhjen e çështjes konkrete. Duke qenë e pasigurt për aktin ku duhet të mbështetet, vetë kjo gjykatë nuk mundet të arrijë në një qëndrim për sa i përket këtij detyrimi.

Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët iu nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës, si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës). Në këtë kuptim, nëse gjyqtari gjatë një gjykimi, arrin në përfundimin se ligji dhe akti nënligjor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, ai është i detyruar të bazohet në ligj. Gjyqtarët duhet të kenë parasysh dhe raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara), sipas nenit 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta i jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla.

Bazuar në vlerësimet e bëra më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka arritur të argumentojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis zgjidhjes së çështjes konkrete dhe dispozitës ligjore që kundërshtohet për pajtueshmëri me Kushtetutën.

Sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar) Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Admir Thanza.

VENDIM
Nr.3, datë 5.2.2010

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 6.10.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.22/13 Akti, që i përket:

KËRKUES: Organizata Profesionale e Ekonomistëve, përfaqësuar nga z. Azis Jata, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga znj. Lefterie Lleshi dhe znj.Elda Jakova, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga znj. Marsida Xhaferrllari dhe znj.Isida Koka, me autorizim.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, i përfaqësuar nga znj.Diana Ylli dhe z.Hysen Çela, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

2. Pezullimi i ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

3.Papajtueshmëria me Kushtetutën e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001.

BAZA LIGJORE: Nenet 131 shkronja “a”, 134 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e Organizatës Profesionale të Ekonomistëve që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar: Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar që kërkuan rrëzimin e saj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. **Kuvendi i Shqipërisë** ka miratuar ligjin nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i cili ka për qëllim “përmirësimin dhe forcimin e mbikëqyrjes publike të profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar” (neni 1). Ky ligj parashikon dispozitat që rregullojnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël, të

shoqërive të auditimit, të kontabilistit të miratuar, si dhe rregullimin e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit.

Fusha e veprimit të këtij ligji, para miratimit të tij, ka qenë rregulluar me akt nënligjor, konkretisht me vendimin nr.150, datë 30.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar”, i ndryshuar.

2. **Kërkuesi** pretendon se ligji objekt shqyrtimi është antikushtetues, pasi:

- Neni 1/10 bie ndesh me parimin e barazisë para ligjit dhe me lirinë e organizimit sipas vullnetit të lirë të individit. U hiqet e drejta të gjithë personave të tjerë, që s’janë anëtarë të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë: IEKA) të organizohen në grupe të tjera përveç organizatës që krijon ligji. Gjithashtu, anëtarësia në organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar prej më shumë se 50 vetë, kufizon shoqatat e tjera me numër më të vogël se ky duke cenuar lirinë e organizimit.

- Parashikimi me ligj i IEKA-s si i vetmi organizëm profesional që grupon ekspertët kontabël krijon situatë monopoli, pasi për të ushtruar këtë profesion duhet të jesh anëtar vetëm i kësaj organizate. Në këtë aspekt, cenohet dhe liria e veprimtarisë ekonomike, pasi ndërhyhet në kriteret e ushtrimit të profesionit të ekspertit kontabël nga shteti.

- Kontrolli që ushtrohet nga Bordi Mbikëqyrjes i IEKA-s nuk është në përputhje me kërkesat e standardet e BE-së, pasi nuk realizon kriteret e pavarësisë për shkak të ndërhyrjes së shtetit me anë të Ministrit të Ekonomisë apo të Drejtësisë. Ky organizëm cenon pavarësinë e ushtrimit të lirë të një profesioni privat siç është ai i ekspertëve kontabël.

- Vlerësimi i njohurive dhe i licencës së marrë nga ekspertët e huaj bëhet nga IEKA duke sjellë konflikt interesi, monopol dhe diskriminim të ekspertëve të huaj përballë atyre vendas.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001, i cili rregullonte më parë profesionin e ekspertit kontabël të autorizuar dhe organizimin e tij është i papajtueshëm me Kushtetutën, sepse nuk mund të vepronte më pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, duke qenë se ka për objekt një veprimtari që duhet të rregullohet me ligj.

- Neni 58 i ligjit që parashikon si kundërvajtje penale përvetësimin e padrejtë të titullit të ekspertit kontabël dhe dënimin me gjobë ose dy vjet burgim për kundërvajtësit është antikushtetues, pasi ligji është miratuar me shumicë të thjeshtë dhe jashtë dispozitave të Kodit Penal.

3. **Subjektet e interesuara** parashtruan kundërshtimet e tyre ndaj pretendimeve si më poshtë:

a) *Përfaqësuesi i Kuvendit:*

- Kërkuesi nuk legjitimohet për arsye se nuk arrin të justifikojë interesat që preken nga objekti i ligjit, i cili është i ndryshëm nga qëllimi për të cilin është krijuar kjo organizatë. Asnjë dispozitë e ligjit nuk synon ndalimin e veprimtarisë së kërkuesit, por ka për synim të rregullojë mbikëqyrjen publike të profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe auditimin ligjor të pasqyrave financiare.

- Ligji nuk përmban asnjë kufizim në lidhje me lirinë e organizimit, pasi organizatat jofitimprurëse rregullohen me ligj të veçantë, ndërsa ligji objekt shqyrtimi rregullon vetëm veprimtarinë e ekspertëve kontabël.

- Nuk ka përplasje apo mbivendosje kompetencash midis IEKA-s dhe Bordit Mbikëqyrës, pasi të parit i janë njohur kompetenca zbatuese e organizative, kurse të dytit kompetenca mbikëqyrëse dhe kontrolli.

b) *Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave:*

- Kërkuesi nuk legjitimohet për të iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt të normës ligjore, për shkak se subjekte të tilla kanë detyrimin të argumentojnë lidhjen e çështjes me interesat e tyre, gjë të cilën kërkuesi nuk rezulton ta ketë bërë përmes kësaj kërkese. Kërkuesi nuk ka dhënë asnjë argument që provon interesin e prekur nga ligji objekt shqyrtimi.

- Pretendimi i kërkuesit se ai dhe të tjerë subjekte të ngjashme janë trajtuar në mënyrë të diferencuar nga IEKA, megjithëse sipas tij ato janë subjekte të njëjta, nuk është i bazuar. Këto organizata ndryshojnë nga njëra-tjetra, pasi IEKA ka për synim mbledhjen e ekspertëve kontabël, rritjen e aftësisë profesionale dhe përmirësimin e njohurive bazë të anëtarëve, si dhe sigurimin e

mirushtrimit të funksionit, mbrojtjen e pavarësisë dhe nderit të anëtarëve të tyre duke bërë njëkohësisht të mundur mbrojtjen e një interesi publik, konkretisht ushtrimin e funksionit të ekspertit kontabël në përputhje me kriteret e ligjit. Ndërsa kërkuesi është një shoqatë që ka për qëllim mbledhjen e lirë të profesionistëve ekonomistë me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre. Për këtë shkak ato nuk mund të jenë të barabarta.

- Nuk qëndron pretendimi se numri kufi i vendosur për organizimet e profesionistëve kontabël të miratuar prej jo më pak se 50 anëtarësh pengon shoqatat e tjera që nuk kanë këtë numër anëtarësh për të ushtruar aktivitetin. Ky aspekt i veprimtarisë nuk lidhet me lirinë e organizimit të individëve, por me të drejtën për të ushtruar një profesion të caktuar. Qëllimi i ligjit është disiplinimi i veprimtarisë së kontabilistëve të miratuar për të pasur një shërbim më efikas dhe më të mirë ndaj publikut.

- Nuk ka asnjë konflikt kompetencash midis IEKA-s dhe Bordit Mbikëqyrës. Ky i fundit është autoriteti që kontrollon ekspertët kontabël dhe shoqëritë audituese me qëllim rritjen e sigurisë dhe transparencës së kontrollit financiar. IEKA është autoriteti që siguron ushtrimin e profesionit në përputhje të plotë me interesat e publikut. Nga ana tjetër, Autoriteti i Certifikimit dhe Autoriteti i Regjistrimit nuk ushtrojnë veprimtari mbikëqyrëse, por detyra dhe kompetenca që lidhen respektivisht me certifikimin e njohurive të kandidatëve për ekspertë kontabël.

- Nuk diskriminohen shtetasit e huaj që duan të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël, pasi ligji parashikon vetëm procedurën ligjore për njohjen e së drejtës për të ushtruar profesionin e ekspertit kontabël, duke sanksionuar vetëm nevojën e një testimi mbi njohuritë e tij në fushën e legjislacionit financiar shqiptar.

- Nuk ka shkelje të dispozitave të Kodit Penal lidhur me parashikimin e mbajtjes së titullit pa të drejtë si kundërvajtje penale, pasi neni 1/a i Kodit Penal parashikon se “Legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe nga ligje të tjera që parashikojnë vepra penale”. Ka një sërë ligjesh që parashikojnë kundërvajtje për vepra të tilla si: këmbim valutor i palicencuar apo veprimtari financiare e palicencuar etj.

- Pretendimi për antikushтетutshmëri të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.2.2000 nuk qëndron, pasi ky akt është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit objekt shqyrtimi (neni 61 i ligjit).

c) Përfaqësuesi i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA):

- Ligji objekt shqyrtimi ka për qëllim të rregullojë ushtrimin e profesionit të ekspertëve kontabël dhe shoqërive audituese mbi baza ligjore dhe konform kërkesave që rrjedhin nga rekomandimet dhe direktivat e BE-së.

- Ligji nuk ka privilegjuar IEKA, por ai ka njohur situatën e mëparshme duke e rikonfirmuar IEKA si autoritet të rregullimit të profesionit të ekspertit kontabël, si dhe duke përcaktuar dhe autoritetet e certifikimit dhe regjistrimit si kërkesa që rrjedhin nga direktiva e tetë e BE-së.

- IEKA nuk mund të jetë njëlloj si organizatat e tjera që mund të veprojnë në treg, pasi ajo ka funksion rregullator, në dallim nga organizatat që krijohen me qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve të vet. Në këtë aspekt, nuk mund të ketë më shumë se një organizëm të tillë në treg, pasi një gjë e tillë nuk do t'i shërbente kontrollit dhe mirëfunksionimit të rolit mbikëqyrës të shtetit në procesin e auditimit ligjor.

- Audituesit e huaj nuk vlerësohen nga IEKA, por nga Autoriteti i Certifikimit dhe ai i Regjistrimit. Qëllimi i kontrollit është nëse titulli i ekspertit kontabël, i regjistruar në vendin e origjinës, është marrë apo jo në përputhje edhe me kriteret që ka legjislacioni ynë për këtë qëllim.

- Anëtarësia minimale për organizatat profesionale në fushën e kontabilitetit me jo më pak se 50 anëtarë është një rregullim ligjor i nevojshëm, i cili jo vetëm nuk cenon të drejtën për t'u vetorganizuar, por garanton një organizim të përshtatshëm dhe një vendimmarrje me bazë sa më të gjerë, duke rritur besimin ndaj këtyre organizimeve dhe duke penguar parcializimin për interesa të ngushta.

II

1. Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar për moslegjitimimin e kërkuësit

Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet, pasi ai nuk ka paraqitur asnjë argument që të justifikojë interesat që i preken atij nga veprimi i ligjit objekt shqyrtimi. Çështjen e legjitimitimit të kërkuësit (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, që përfshihen në subjektin kushtetues “organizatat e tjera”, janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta.” (*Shih vendimet nr.35, datë 10.10.2007; nr.25, datë 5.12.2008; nr.17, datë 25.7.2008; nr.31, datë 2.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*)

Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, shkronja “f” të Kushtetutës dhe neni 49 pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ai është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2527, datë 7.4.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me 5 anëtarë themelues. Në statutin e organizatës, neni 2, parashikon se organizata ka për qëllim rritjen e aftësive profesionale dhe përmirësimin e njohurive bazë të atyre që dëshirojnë të merren me kontabilitet dhe auditim, zhvillimin e programeve profesionale, përmirësimin e punës së audituesve, organizimin e trajnimeve të ndryshme etj.

Duke qenë se ligji objekt shqyrtimi përcakton, përveç të tjerave, edhe rregullat për ushtrimin e profesionit të anëtarëve të organizatës që përfaqëson kërkuesi, Gjykata çmon se ai ka interes të drejtpërdrejt në paraqitjen e kërkesës para saj për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji dhe për këtë arsye legjitimohet në kërkimet e tij.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e lirisë së organizimit dhe parimit të barazisë

Kërkuesi pretendon se neni 2, pika 10 dhe 11 të ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar”, cenon lirinë e organizimit të anëtarëve të organizatës që ai përfaqëson, pasi nëpërmjet këtij parashikimi përcaktohet se të gjithë ekspertët kontabël duhet të mblidhen në një organizëm të vetëm, pra në organizatën profesionale të ekspertëve kontabël të regjistruar, së cilës, me anë të këtij ligji, i është vënë emërtimi “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar” (më poshtë IEKA).

Gjykata konstaton se IEKA është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.3573, datë 16.10.1998 dhe deri para miratimit të ligjit objekt shqyrtimi e ka mbështetur veprimtarinë e saj në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.150, datë 30.3.2000 “Për miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar”, të ndryshuar. Krijimi i IEKA-s shënon fillimin e organizimit të profesioneve të lira e të pavarura me bazë kontabilitetin. Procesi i përgatitjes së profesionistëve të auditimit dhe i organizimit të tyre ka nisur me miratimin e ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, i cili më vonë u amendua duke përfshirë një sërë dispozitash për auditimin ligjor të shoqërive tregtare nga profesionistët e auditimit që tek ne u quajtën “ekspertë kontabël të autorizuar”¹. Ky ligj autorizoi Këshillin e Ministrave të nxirrte rregulla të hollësishme për organizimin profesional, gjë që u realizua me urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.1 datë 2.10.1995 e më pas, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000. Miratimi i një ligji specifik për rregullimin e profesionit të ekspertit kontabël dhe auditimin ligjor në Republikën e Shqipërisë lindi si nevojë për të rregulluar me ligj formal organizimin dhe funksionimin e organeve kompetente në fushën e auditimit ligjor me qëllim ushtrimin e profesionit të

¹ Nenet 167-185 të ligjit të mëparshëm, i cili u shfuqizua nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

ekspertëve kontabël sipas kërkesave të kohës dhe përmirësimin e rolit të mbikëqyrjes publike duke përfshirë në ligj dhe aspekte të tjera të ushtrimit të këtij profesioni, përveç atyre të parashikuara më parë me akt nënligjor (kupto: vendim të Këshillit të Ministrave).

Ligji objekt shqyrtimi, përveç të tjerave, rikonfirmoi rolin dhe vazhdimësinë e funksionimit të IEKA-s, si një organizëm, ngritja dhe funksionimi i të cilit tashmë bazohet në rregulla më të detajuara. Dispozitat e këtij ligji synonin jo vetëm rregullimin e organizimit institucional, por edhe kryerjen e shërbimeve profesionale nga anëtarët e tij (kupto: IEKA), ku përfshihen standardet e punës, të etikës profesionale, të kontrollit të cilësisë dhe të kualifikimit të vijueshëm të audituesve. Në kornizën rregullatore të funksionimit të Institutit theksohet se “*Objekti i veprimtarisë së tij është të sigurojë mirushtrimin e profesionit, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij, si dhe mbikëqyrjen e formimit profesional të tyre*”. Pra, IEKA është një organizëm me funksion publik, i cili autorizohet nga shteti, nëpërmjet ligjit, për të kryer kontrollin dhe mbarëvajtjen e certifikimit të punës dhe veprimtarisë së ekspertëve kontabël dhe kontabilistëve të miratuar.

Nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuesit për cenim të lirisë së organizimit të individëve, parashikuar nga neni 46 i Kushtetutës, nuk është i bazuar dhe duhet rrëzuar. Liria e organizimit, si një liri negative e garantuar nga Kushtetuta ka për qëllim dhënien e mundësisë shtetasve për t’u grumbulluar dhe organizuar të lirë dhe sipas preferencës, për synime dhe objektiva të përbashkëta, të cilat jo domosdoshmërisht lidhen me ushtrimin e profesionit. Njihen dhe organizime të cilat mbi bazën e tyre kanë mbrojtjen e interesave profesionale si p.sh sindikatat, ngritja dhe veprimtaria e të cilave është e garantuar nga vetë Kushtetuta në nenin 50 të saj. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se kushtëzimi i ushtrimit të profesionit të ekspertit kontabël me anëtarësinë në IEKA dhe qenia e këtij të fundit si organizmi i vetëm që grumbullon të gjithë ekspertët kontabël, nuk bie ndesh me Kushtetutën, konkretisht me nenin 46 të saj që garanton lirinë e organizimit të individëve sipas dëshirës. Qëllimi i ligjvënësit në këtë rast është rregullimi dhe mirëfunksionimi i një profesioni specifik, i cili megjithëse ushtrohet në mënyrë private, ka natyrë publike dhe si i tillë nevojitet të rregullohet dhe të mbikëqyret vazhdimisht nga shteti, direkt apo nëpërmjet organizmave të krijuara me ligj.

Auditimi ligjor është një nga funksionet më të rëndësishme në një shtet. Ai nënkupton “*kontroll formal të regjistrave kontabël apo situatës financiare të një personi fizik apo juridik, dhe përputhjen me standardet e përcaktuara*”². Pra, përgatitja e pasqyrës mbi gjendjen financiare të një personi fizik ose juridik, ose siç njihet ndryshe ‘bilanc financiar’, realizohet nga ekspertë financiarë që kanë titullin “kontabilistë të miratuar”. Ndërsa kontrolli i saktësisë së këtyre bilanceve dhe respektimi prej tyre i standardeve të përcaktuara për këtë qëllim bëhet nga një kategori tjetër profesionistësh konkretisht, ekspertët kontabël të regjistruar. Këta të fundit janë të ngarkuar me ligj që të kontrollojnë nëse bilancet apo gjendja financiare e një subjekti të caktuar është apo jo e saktë dhe e rregullt. Ky funksion, për shkak të specifikës që ka, nuk mund të jetë në asnjë rast funksion privat dhe nuk mund të ushtrohet prej çdokujt pa kufizim ose pa kritere të përcaktuara paraprakisht. Ligji parashikon kritere të qarta për mënyrën se si licencohen apo certifikohen ekspertët kontabël.

Në përmbledhje të sa më lart, Gjykata çmon se kontrolli që ushtrojnë ekspertët kontabël ndaj punës së kontabilistëve për saktësinë dhe rregullsinë e bilanceve financiare është një funksion publik i shtetit i deleguar tek ekspertët kontabël. Është kjo arsyeja që mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre nuk mund të jetë e pakontrolluar dhe e lirë nga çdo lloj rregullimi ligjor. Për këtë qëllim, ligji parashikon IEKA-n si një organizëm që mbledh të gjithë ekspertët kontabël të regjistruar dhe kontabilistët e miratuar si të vetmin forum me qëllim mbarëvajtjen e punës së profesionistëve në fjalë. IEKA është një forum që merret me “*çështjet që prekin ekspertët kontabël, kujdeset për përgatitjen dhe formimin e mëtejshëm profesional të anëtarëve të saj, harton programet e stazhit profesional, organizon sistemin e kontrollit të cilësisë së punës së ekspertëve kontabël dhe kryen investigime të nevojshme në rast të shkeljes së standardeve teknike dhe të etikës profesionale*” (neni 12 i ligjit).

² Përkufizim i marrë nga Black’s Law Dictionary.

Pra, në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se rregullimi profesional i IEKA-s vlerësohet si një vetërregullim i mbikëqyrur nga autoriteti i parashikuar për këtë qëllim për shkak të funksionit publik që i ngarkohet me ligj. Funkzioni kryesor i ekspertit kontabël është mbrojtja e interesit publik, e cila mund të garantohet realisht, nëse anëtarët që ushtrojnë këtë profesion angazhohen për zbatimin e rregullave etike dhe standardeve teknike cilësore, duke dalë përtej interesave të drejtpërdrejta të klientit apo kontraktuesit direkt të shërbimit, duke përfaqësuar edhe përdoruesit e pakontraktuar të shërbimeve kontabël siç janë për shembull shteti, investitorët, kreditorët etj.

Në vijim të argumenteve të mësipërme, Gjykata e konsideron të pabazuar edhe pretendimin lidhur me përcaktimin e numrit prej 50 anëtarësh, si kusht për krijimin e organizatës profesionale të kontabilistëve të miratuar që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shërbimeve të kontabilitetit, ku përfshihen edhe shoqëritë e kontabilitetit (neni 1/11 i ligjit). Ky kusht nuk lidhet me lirinë e organizimit të individit, por me sigurimin e standardit në dhënien e titullit profesional të kontabilistit, mbajtjen e regjistrave publikë të personave që e gëzojnë titullin profesional, e në vazhdimësi për të siguruar ruajtjen e standardeve profesionale. Për efekt të mirëfunksionimit dhe mosabuzimit me krijimin e organizmave të tillë në mënyrë të panevojshme dhe/ose të dëmshme për ushtrimin e profesionit të kontabilistit të miratuar, ligjvënësi ka vendosur një numër minimal kufizues me qëllim parandalimin e dukurive negative të shfaqura në këtë sektor.

Gjykata, bazuar në arsyetimin e dhënë më lart, çmon se edhe pretendimi për cenimin e parimit të barazisë, për shkak të trajtimit diskriminues ndaj organizatës që përfaqëson kërkuesi, nuk është i bazuar. Siç u argumentua më sipër, IEKA nuk merr përsipër të përfaqësojë interesat private të anëtarëve të saj, por të garantojë ushtrimin në përputhje me kërkesat e ligjit të funksionit publik të ngarkuar me delegim ekspertëve kontabël. Këta të fundit mbeten të lirë të organizohen, sipas dëshirës, në cilindo organizëm privat me qëllim shpalosjen e interesave apo synimeve të përbashkëta, sikundër ka vepruar dhe kërkuesi duke krijuar organizatën profesionale të ekonomistëve. Organizata që përfaqëson kërkuesi dhe IEKA kanë objekt të ndryshëm dhe natyra e krijimit të tyre është e ndryshme. IEKA është e krijuar me ligj për të ushtruar një funksion publik, kurse kërkuesi përfaqëson një person juridik privat që është regjistruar sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe ka për qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj. Duke qenë organizma të ndryshëm, të krijuar për qëllime dhe mbi baza ligjore të ndryshme, është e qartë dhe e kuptueshme që ato nuk mund të trajtohen njëllë nga legjislacioni shqiptar. Këtu nuk gjen vend as pretendimi për diskriminim, pasi për nga vetë natyra që kanë këto subjekte, është lehtësisht e kuptueshme se ato përfaqësojnë dhe mbrojnë interesa të ndryshme.

3. Lidhur me pretendimin për pozicionin monopol të auditimit ligjor në treg

Kërkuesi pretendon se duke parashikuar me ligj ekzistencën e IEKA-s si të vetmin organizëm profesional që grupon ekspertët kontabël, krijohet një situatë monopoli, pasi për të ushtruar këtë profesion duhet të jesh anëtar vetëm i kësaj organizate.

Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar. Siç u argumentua më lart, auditimi ligjor është një auditim i detyrueshëm i pasqyrave financiare dhe ka për qëllim të mbrojë interesin publik. Në mjaft legjislacione kjo kërkesë është sanksionuar në legjislacionin tregtar (edhe ligji ynë për shoqëritë tregtare ka parashikuar një detyrim të tillë). Nga ana tjetër, shërbimi i auditimit ligjor aktualisht realizohet nga një numër i konsiderueshëm ekspertësh kontabël të regjistruar. Aktualisht në treg ka 144 ekspertë kontabël të regjistruar, të cilët ushtrojnë profesionin në mënyrë aktive (ka rreth 60 ekspertë kontabël që nuk janë aktivë, pasi nuk e ushtrojnë profesionin), ka 23 firma auditimi vendase dhe 8 firma auditimi të huaja, përfshirë këtu edhe katër firmat më të mëdha të auditimit në shkallë globale. Rezulton se edhe hyrja në profesion është e liberalizuar për këdo që plotëson kushtet dhe që i nënshtrohet procesit të përgatitjes dhe testimit.

Organizimi i profesionit të audituesit në të gjitha vendet e BE-së ka në themel direktivën 2006/43/EC të BE-së “Për auditimin e detyrueshëm të llogarive vjetore” dhe i detyron të gjitha shtetet e Bashkimit Europian të përshtasin legjislacionin e tyre për auditimin dhe audituesit me këtë direktivë, brenda vitit 2008. Në pothuaj të gjitha vendet e BE-së, por edhe ato aspirante, sipas informacionit të paraqitur edhe nga subjekti i interesuar, IEKA ka vetëm një organizëm profesional për audituesit, që buron nga ligjet apo aktet rregullatore bazë, pavarësisht faktit që në disa vende,

për shkak të traditës së tyre, organizmat profesionale grupojnë përveç audituesve edhe kontabilistët e miratuar³. Një organizëm profesional vetëm për audituesit vihet re edhe në vendet e rajonit, apo ato të Mesdheut, ku profesioni i audituesit i nënshtrohet një sistemi të pavarur të mbikëqyrjes publike. Për të hyrë në profesion, direktiva e tetë e BE-së parashikon një periudhë të detyrueshme stazhi prej të paktën tri vjetësh, nga e cila 2/3 duhet të jetë në fushën e auditimit ligjor.

Në këtë këndvështrim, Gjykata thekson se nuk mund të flitet për ekzistencën e situatës së monopolit, pasi ligji nuk pengon asnjë person për marrjen e licencës së ekspertit, ai vetëm rregullon mënyrën e fitimit të licencës dhe kontrollin e vazhdueshëm të tij. Përveç kësaj, kundër situatës së monopolit flet edhe fakti se IEKA, si organizëm profesional, nuk kryen auditime ligjore, dhe se ai është një organizëm jofitimprurës, i cili është i njohur nga shteti për të marrë përsipër disa aspekte rregullative të profesionit të audituesit ligjor. Në këtë kuptim, ligji e njeh IEKA-n si autoritet kompetent që ka përgjegjësinë, nën mbikëqyrjen e Bordit, për disa çështje të rregullimit të profesionit.

Neni 3, paragrafi i dytë i pikës 2 të direktivës së tetë të BE-së shprehet se organizata profesionale mund të caktohet nga shtetet anëtare si autoritete kompetente për rregullimin dhe mbikëqyrjen e profesionit. Pra, në këtë kuptim roli i IEKA, si autoritet kompetent i mbikëqyrur, është të rregullojë vetëm një pjesë të aspekteve të profesionit, pasi sikurse shikohet në ligj, certifikimi, regjistrimi, çregjistrimi dhe disiplina nuk mbulohen nga Instituti, por nga autoritete të tjera të pavarura, ku natyrisht Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka rolin parësor. Të gjithë këto autoritete të ndryshme, me punën e tyre, bëjnë të mundur që profesionistët (audituesit ligjorë) të japin shërbime cilësore në interes të publikut.

4. Lidhur me pretendimin për cenim të pavarësisë në ushtrimin e profesionit të ekspertit kontabël nga ndërhyrjen e shtetit

Kërkuesi pretendon se kontrolli që ushtrohet nga Bordi Mbikëqyrës i IEKA-s nuk është në përputhje me kërkesat e standardet e BE-së, pasi nuk realizon kriteret e pavarësisë për shkak të ndërhyrjes së shtetit me anë të Ministrit të Ekonomisë apo Ministrit të Drejtësisë.

Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim nuk është i bazuar dhe duhet rrëzuar. Nëse do t'i referohemi direktivës së BE-së mbi kontrollin (auditin) ligjor në vendet e BE-së, në nenin 32 të saj, thuhet: *“Shtetet anëtare duhet të organizojnë një sistem efektiv të mbikëqyrjes publike të ekspertëve kontabël dhe të firmave që kryejnë audit, bazuar në parimet e parashikuara në pg.2-7. Të gjithë ekspertët kontabël duhet t'i nënshtrohen kontrollit. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të drejtohet nga jopraktikantë, të cilët kanë njohuri nga fusha ose fusha të ngjashme me auditin. Anëtarët e autoritetit të mbikëqyrjes publike zgjidhen nëpërmjet një procedure të pavarur dhe transparente⁴”.*

Gjykata konstaton se formulimi që përmban neni 4 i ligjit objekt shqyrtimi është në përputhje me këtë rregullim të BE-së. Ai parashikon përbërjen dhe funksionimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, i cili ka për detyrë kontrollin e të gjithë ekspertëve kontabël të regjistruar dhe firmave audituese (neni 3). Pra, nisur nga ky fakt, nuk rezulton të ketë asnjë papajtueshmëri ose konflikt interesi siç pretendon kërkuesi, i cili paraqet si argument se vetë organizata e profesionistëve kontrollon anëtarët e saj. Jo vetëm kaq, por u siç u përmend edhe më sipër, pjesëmarrja e autoritetit publik gjatë kontrollit të veprimtarisë së ekspertëve kontabël i shërben interesit publik dhe nuk mund të konsiderohet si ndërhyrje në ushtrimin e lirë të veprimtarisë ekonomike (neni 11), ndryshe nga sa pretendon kërkuesi. Është e vërtetë se profesioni i ekspertit kontabël është profesion i lirë, por kjo nuk do të thotë se është i pakontrollueshëm. Për më tepër ligjvënësi është kujdesur që ky kontroll jo vetëm të jetë kolegjal, por edhe përzgjedhja të jetë e tillë që të mos dominohet nga profesionistë të fushës për të qenë më objektivë në vlerësim. Ashtu si profesionet e tjera të lira (avokatia, noteria), edhe ky profesion ka nevojë për kontroll të

³ Përfshihet nga pjesa e tjetër e Europës, në Mbretërinë e Bashkuar ka dy organizma kombëtare të profesionit kontabël (ICAS – Skoci dhe ICAEW- Angli e Uells) dhe një organizatë ndërkombëtare të profesionit (ACCA). Kjo shpjegohet me mënyrën e veçantë të organizimit të këtij shteti dhe traditën e tyre ligjore.

⁴ Directive 2006/43/EC of the European Parliament and of the Council of 17 May 2006 on statutory audits of annual accounts and consolidated accounts, amending Council Directives 78/660/EEC and 83/349/EEC and repealing Council Directive 84/253/EEC, Art.32.

vazhdueshëm (kupto: mbikëqyrje publike) me qëllim kryerjen e funksionit publik në përputhje me kërkesat e ligjit. E rëndësishme është që ky kontroll të bëhet sipas ligjit dhe parimeve themelore për ushtrimin e profesioneve me karakter publik, siç është rasti i ekspertëve kontabël.

5. Lidhur me pretendimin për diskriminimin e ekspertëve kontabël të huaj

Kërkuesi pretendon se vlerësimi i ekspertëve të huaj bëhet nga Organizata Profesionale e Ekspertëve Kontabël, pra IEKA, duke sjellë konflikt interesi dhe monopol. Megjithëse kërkuesi nuk jep asnjë argument lidhur me këtë pretendim, Gjykata e sheh me vend të nënvizojë se procedura e parashikuar nga neni 22 i ligjit për certifikimin e ekspertëve të huaj nuk rezulton të përmbajë ndonjë element që mund të sjellë konflikt interesi apo cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike. I vetmi veprim që bën IEKA është verifikimi nëse kushtet e përgatitjes së ekspertit të huaj përputhen apo jo me kushtet e përgatitjes së ekspertëve vendas. Madje, është pikërisht ky element që shmang edhe ndonjë diskriminim të mundshëm midis ekspertëve të huaj dhe atyre vendas, nëse do të ndodheshim para diferencave në formimin profesional. Thjesht vendosja e disa kriterëve për shtetasit e huaj, me qëllim ushtrimin e funksionit të ekspertit kontabël në Republikën e Shqipërisë, nuk sjell detyrimisht diskriminim të tyre. Përderisa shtetasit e huaj do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, ata duhet të jenë në gjendje të provojnë njohuri të mjaftueshme lidhur me legjislacionin tregtar apo fiskal vendas, për t'i shërbyer kështu sa më mirë publikut në përgjithësi dhe klientëve në veçanti. Kjo kërkesë e vetme ligjore me qëllim ushtrimin e profesionit të ekspertit kontabël jo vetëm që nuk pengon shtetasit e huaj për të punuar si ekspertë kontabël, po madje mund të konsiderohet si një nga sistemet ligjore liberale për shkak të kriterit minimal të vendosur për këtë qëllim nga ligjvënësi.

6. Lidhur me pretendimin për parashikimin e masave ndëshkimore

Kërkuesi pretendon se neni 58 i ligjit është antikushtetues, pasi parashikon si kundërvajtje penale jashtë dispozitave të Kodit Penal, përvetësimin e padrejtë të titullit të ekspertit kontabël duke e shoqëruar edhe me sanksionin përkatës, gjobë ose burgim deri në 2 vjet.

Gjykata thekson se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përmbledhen në mënyrë të sistemuar dispozitat penale-juridike. Ky Kod përmban jo vetëm parimet kryesore mbi të cilat duhet të mbështetet drejtësia penale, por edhe veprat të cilat konsiderohen si të dënueshme. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Qëllimi i këtij parimi është jo vetëm respektimi i ligjit për çdo rast dhe për çdo vepër penale, por edhe njohja e subjekteve me të gjitha ato veprime apo mosveprime, të cilat konsiderohen të dënueshme. Duke qenë se Kodi Penal, krahas Kushtetutës, është burimi kryesor i së drejtës penale dhe në zbatim të parimit të ligjshmërisë, parashikimi i veprave penale duhet të bëhet pikërisht në këtë Kod, si ligji bazë që parashikon krimet dhe kundërvajtjet penale ose në një ligj të barazvlefshëm me të nga fuqia juridike. Një gjë e tillë u vjen në ndihmë shtetasve, të cilët mund të orientohen më mirë në kuadrin e gjerë të ligjeve që mund të parashikojnë vepra penale, me qëllim njohjen e tyre me ndalimet ligjore sipas fushave të ndryshme.

Gjykata çmon se dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar – në rastin konkret mbajtjen e padrejtë të titullit të ekspertit kontabël – si vepër penale, jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim. Dënimi penal është masë shtrënguese që zbatohet nga shteti nëpërmjet gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer veprën penale. Ai dallohet nga masat e tjera shtrënguese që merr shteti ndaj personave që kryejnë vepra penale për shkak të pasojave që ka. Në interpretim të nenit 1/a të Kodit Penal, i cili parashikon se legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe ligje të tjera që parashikojnë vepra penal, Gjykata Kushtetuese çmon se për këtë qëllim, me ligje të tjera do të kuptohen ato akte të ligjvënësit që miratohen me shumicë të cilësuar prej 3/5 të anëtarëve të tij. Për këtë arsye, ligjvënësi duhej të kishte gjetur mekanizmin e përshtatshëm procedural që, në kuadër të garancisë për ushtrimin e profesionit të ekspertit kontabël dhe në përputhje me kriteret ligjore për këtë qëllim, të respektonte shumicën e cilësuar prej 3/5 për dispozitën që parashikon veprën penale.

Gjykata Kushtetuese ka tashmë praktikë të konsoliduar lidhur me respektimin e kriterëve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, të cilat duhen respektuar gjatë procedurës ligjvënëse.

Kështu, një nga kriteret është edhe kriteri formal i miratimit të një ligji që kërkon shumicë të cilësuar, në respektim të nenit 81/2 të Kushtetutës (vendime të Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007; nr.25, datë 15.12.2008).

Nga sa më lart, Gjykata çmon se neni 58 i ligjit objekt shqyrtimi, që parashikon mbajtjen e padrejtë të titullit të ekspertit kontabël si kundërvajtje penale, nuk është në pajtim me nenin 81/2 të Kushtetutës.

7. Lidhur me pretendimin për antikushtetutshmëri të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000

Kërkuesi pretendon se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000, është antikushtetues, pasi nëpërmjet tij është rregulluar veprimtaria e një organizate jofitimprurëse, duke synuar frenimin e iniciativës së lirë në treg.

Gjykata konstaton se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000, i ndryshuar, është miratuar me qëllim organizimin dhe funksionimin e auditimit ligjor dhe ekspertit kontabël. Më vonë, ligjvënësi vlerësoi nevojën për nxjerrjen e një ligji të veçantë për rregullimin e këtyre çështjeve me synimin për të përfshirë edhe aspekte të tjera të ushtrimit të këtij profesioni si dhe duke përmirësuar ato ekzistuese. Për këtë qëllim u miratua ligji nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i cili në nenin 61 të tij (Dispozitat kalimtare) ka parashikuar se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.150, datë 31.3.2000 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të ligjit. Për këtë arsye, Gjykata çmon se një akt, i cili nuk është më në fuqi dhe nuk sjell asnjë efekt juridik, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “a”, 134 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e nenit 58 të ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” .

- Rrëzimin e kërkesës për pjesët e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe, për shkak të boshllëkut ligjor që krijohet nga shfuqizimi i nenit 58 të ligjit nr.10091, datë 5.3.2009, hyn në fuqi 6 muaj pas botimit të këtij vendimi në Fletore Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar) Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Xhezair Zaganjori, Petrit Piloçi, Admir Thanza.

Anëtarë pjesërisht kundër: Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Sokol Berberi.

VENDIM
Nr.4, datë 12.2.2010

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.12.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27, 29/13/1 Akti që i përket:

KËRKUES: Shoqata e ish të Burgosurve Politike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Tanush Kaso.

Shoqata Kombëtare e Dëbim-Internimeve Politike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Abdyyrahman Çekiçi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj me autorizim.
- Këshilli i Ministrave në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18, 44, 131 germa “a” dhe 134 pika 1, germa “f” të Kushtetutës; dhe neni 48 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha; kërkuesit që u shprehën për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që u shpreh për rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”. Ligji ka për objekt dëmshpërblimin financiar të ish të dënuarve politikë, familjarëve të viktimave të ekzekutuara apo të pushkatuara padrejtësisht për motive politike, si dhe të internuarve ose të dëbuarve. Për këtë qëllim, ligji ka përcaktuar jo vetëm kategoritë përfituese, por edhe masën, kriteret dhe procedurat përmes të cilave fitohet e drejta për dëmshpërblim financiar.

Shoqata e ish të Burgosurve Politike të Shqipërisë (SHBPSH) dhe Shoqata Kombëtare e Dëbim-Internimeve Politike në Shqipëri (SHKDISH) i janë drejtuar veçmas Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” (në vijim ligji nr.9831).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 1 pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe në nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi bashkimin e shqyrtimit të çështjeve të paraqitura nga kërkuesit, për shkak të objektit të njëjtë të tyre.

Kërkuesit kanë pretenduar se ligji, objekt kundërshtimi, cenon parimet kushtetuese të barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike, duke argumentuar se:

- Janë përjashtuar pa të drejtë nga përfitimi i dëmshpërblimit: familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq; një pjesë e madhe e të internuarve dhe të dëbuarve, për shkak të kërkesave të ligjit për të vërtetuar statusin me dokument të krijuar si burim arkivor para datës 1.11.1991, kur dihet që ky burim mungon; një pjesë e familjarëve të viktimave të ekzekutuara apo pushkatuara me vendime penale të gjykatave, pasi ligji ka ngushtuar rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të tyre; kategoria e personave që janë të sëmurë psikikë për shkak të përndjekjes; kategoria e të përndjekurve në periudhën nga 8.11.1941 deri në 30.11.1944, pasi ligji rregullon dëmshpërblimin e kategorisë së të përndjekurve nga regjimi komunist për periudhën 30.11.1944 deri më 1.10.1991;

- Ligji bën diferencime në mënyrën e trajtimit financiar të kategorisë së të internuarve dhe të dëbuarve, pasi personat që kanë vuajtur internimin në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954 përfitojnë dëmshpërblim 1000 (njëmijë) lekë në ditë, ndërsa për personat e internuar ose të dëbuar pas vitit 1954 parashikohet një skemë pensioni që do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Kushtet dhe kriteret e përcaktuara për përfitimin e dëmshpërblimit financiar sjellin si pasojë mospërfitimin e kësaj të drejte, pasi: (a) kriteret e përcaktuara në shkronjën “a” të nenit 4 vijnë në kundërshtim me ato të parashikuara në shkronjën “ç” të po këtij neni, sepse mohojnë efektet e ligjit nr.7514, 30.9.1991 “Për pafajësinë...”; (b) neni 4, pika “d” është dispozitë evazive dhe lë vend për interpretime të ndryshme, pasi nuk përcaktohet qartë se cilat duhet të jenë pasojat për jetën e shtetasve të tjerë; (c) në veprat penale politike, sipas nenit 5 të ligjit, nuk përfshihen dekretligjet për dënimet administrative, për dëbim internimet, nenet 21-22 të Kodit Penal të vitit 1952 dhe nenet 26-27 të Kodit Penal të vitit 1977; (ç) neni 6 paragrafi i fundit është gjithashtu dispozitë evazive që lë vend për interpretime të ndryshme, pasi nuk parashikon metodologjinë me të cilën do të përcaktohet ndikimi i dëmshpërblimit të mëparshëm në dëmshpërblimin financiar në zbatim të ligjit objekt shqyrtimi; (d) masa e dëmshpërblimit për familjarët e të dënuarve me dënim kapital, e përcaktuar në nenin 7, është diskriminuese, pasi vlerësimi i jetës së humbur nuk bëhet mbi baza ligjore; (dh) kriteret për ndarjen e fondit, të sanksionuara në nenin 12, nuk janë të qarta; (e) afati njëvjeçar për paraqitjen e kërkesës për përfitimin e dëmshpërblimit, i përcaktuar në nenin 19, është i shkurtër dhe privon nga kjo e drejtë një numër të konsiderueshëm ish të dënuarish politikë dhe të përndjekurish; (ë) plotësimi i dokumenteve shoqëruese të kërkesës për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas përcaktimit të nenit 20, është i perealizueshëm dhe abstrakt; (f) neni 24 pika “a”, që parashikon mënyrën dhe afatin e plotësimit të dokumenteve që mungojnë, është përjashtues, pasi nuk merr në konsideratë dokumentet e vuajtjes së dënimit, të dhëna nga komisioni i krijuar për vërtetimin e kohës së dënimit administrativ me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445, datë 13.12.1991; (g) neni 32, që sanksionon planifikimin e fondeve dhe skemën e shpërndarjes së tyre, nuk përmbush qëllimin e ligjit që është rehabilitimi i ish të dënuarve politikë.

Përfaqësuesi i **subjektit të interesuar Kuvendi i Shqipërisë**, pretendoi se:

- Kërkuesit nuk legjitimohen për të kërkuar shfuqizimin e ligjit objekt shqyrtimi, pasi ata nuk përfaqësojnë të gjithë kategoritë e ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist dhe kërkesa e tyre nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera.

- Neni 44 i Kushtetutës siguron dëmshpërblimin e personave të dëmtuar, por ky nen nuk detyron dëmshpërblim edhe për rrethin e trashëgimtarëve.

- Kërkuesit kanë detyrimin për të provuar me fakte dhe prova kërkesat për dëmshpërblim financiar, prandaj dhe vështirësitë që hasin si subjekte përfituese për gjetjen e dokumentacionit janë pjesë e një procesi administrativ dhe jo pjesë e një gjykimi kushtetues.

- Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar pasi ligji nuk përmban asnjë normë që përjashton shprehimisht ndonjë prej kategorive përfituese nga dëmshpërblimi financiar.

II

Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar për moslegjitimimin e kërkuesve

1. Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë ka pretenduar se kërkuesit nuk përfaqësojnë gjithë kategoritë e të ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist dhe kërkesat e tyre nuk janë mbështetur nga shoqatat e tjera të ish të dënuarve politikë.

2. Çështjen e legjitimitit, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në funksion të legjitimitit *ratione personae*, Gjykata ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në "... organizata të tjera" të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, duke përfshirë organizatat politike (neni 131 shkronja "d"), etnike, kulturore, fetare, gjuhësore (neni 20/2), sindikale (neni 50), shoqërore, ekonomike, tregtare (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2). Pra, Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë termit "organizatë" edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve, me kushtin që organizimi, programet dhe veprimtaria e tyre të përputhen me parimet demokratike të shtetit të së drejtës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.7.2008*)

3. Gjithashtu, në vështrim të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.3.2008 dhe nr.17, datë 25.7.2008*).

4. Gjykata konstaton se Shoqata e ish të Burgosurve Politikë është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 3.2.1997 si person juridik-shoqatë. Sipas aktit të themelimit dhe statutit, ajo është një organizatë e pavarur, shoqërore, pluraliste dhe joqeveritare, e cila bashkon ish të burgosurit politikë dhe lufton me të gjitha format dhe mjetet e mundshme demokratike që shteti t'u sigurojë ish të burgosurve politikë të drejtat e garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet, si dhe nga aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se edhe Shoqata Kombëtare e Dëbim-Internimeve Politike është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 4.5.2006 si person juridik - shoqatë. Sipas aktit të themelimit dhe statutit, ajo është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare, e cila ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të përndjekurve politikë të të gjitha grupeve, duke synuar kryesisht integrimin e tyre të plotë dhe të barabartë në shoqërinë demokratike.

5. Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen (*locus standi*) për vënien në lëvizje të kësaj gjykate, sepse objekti i ligjit të kundërshtuar për papajtueshmëri me Kushtetutën është përcaktimi i përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit financiar për ish të dënuarit politikë, ndërkohë qëllimi i tyre është mbrojtja e të drejtave të ish të dënuarve politikë, të sanksionuara nga legjislativi vendas, si dhe nga aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këto kushte, ekziston edhe lidhja e domosdoshme ndërmjet qëllimit për të cilin janë krijuar të dy shoqatat dhe çështjes kushtetuese të ngritur prej tyre.

6. Përsa i përket pretendimit të subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, se kërkuesit nuk legjitimohen pasi nuk përfaqësojnë të gjithë kategoritë e të ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist dhe se kërkesa e tyre nuk është mbështetur nga shoqatat e tjera të ish të dënuarve politikë, Gjykata e vlerëson të pabazuar. Për efekt të legjitimitit, nuk është e nevojshme që kërkuesit të provojnë se përfaqësojnë të gjithë ish të dënuarit politikë nga regjimi komunist apo kërkesa e tyre të mbështetet edhe nga shoqatat e tjera, pasi në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, i cili përcakton rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimimin.

7. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se, mbështetur në nenin 134, pika 1, shkronja "f", dhe 134 pika 2 të Kushtetutës, Shoqata e ish të Burgosurve Politikë dhe Shoqata Kombëtare e Dëbim - Internimeve Politike legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist".

III

Gjykata konstaton se gjatë shqyrtimit të çështjes, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr.10111, datë 2.4.2009 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” (ligji nr.10111). Për këtë arsye, Gjykata vlerëson që gjatë analizës së pretendimeve të kërkuarve t’i referohet ndryshimeve, duke qenë se ato sjellin disa rregullime të reja edhe në lidhje me pretendimet e parashtruara nga kërkuarët në këtë gjykim.

i) Në çështjen në shqyrtim, një nga pretendimet e kërkuarve është se familjarët e rreth 4000 viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq janë përjashtuar nga e drejta e dëmshpërblimit financiar, ndonëse kjo e drejtë parashikohet në nenin 3 shkronja “a” të ligjit nr.7748, datë 29.07.1993 “Mbi statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, që është në fuqi.

Gjykata vëren se ligji objekt shqyrtimi, në nenin 1, përcakton si kategori përfituese të dëmshpërblimit financiar: (a) ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur persekutimin e drejtpërdrejtë në regjimin komunist, nëpërmjet kryerjes së dënimeve penale të padrejta, si burgim apo masa mjekësore të detyrueshme, si pasojë e një apo disa vendimeve të formës së prerë të gjykatave të zakonshme, të gjykatave speciale apo të urdhrave të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991; (b) familjarët e viktimave të ekzekutuara apo të pushkatuara padrejtësisht për motive politike, me vendime penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme apo speciale, ose me urdhra të organeve të hetuesisë gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991; (c) personat e internuar ose të dëbuar, me kusht që humbja e jetës apo periudha e vuajtjes së internimit ose dëbimit të vërtetohet me dokument, të krijuar si burim arkivor para datës 1.10.1991.

Ndryshimet e bëra me ligjin e ri (neni 1 i ligjit nr.10111) ngarkojnë *Këshillin e Ministrave që të përcaktojë me vendim procedurat e shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masën e dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991.*

Gjykata vlerëson se rregullimi i mësipërm ligjor, në dallim nga ai i mëparshëm, ka zgjeruar rrethin e përfituesve, pasi i ka njohur të drejtën e dëmshpërblimit edhe familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq. Ligji i ri nuk parashikon procedurën e shqyrtimit administrativ të kërkesave të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq dhe masën konkrete të dëmshpërblimit financiar të tyre, por ligji ia ngarkon këtë kompetencë Këshillit të Ministrave. Dhënia e kësaj kompetence Këshillit të Ministrave është në përputhje me nenin 118/2 të Kushtetutës dhe synon të lehtësojë procedurat për konkretizimin e qëllimit të parashikuar në nenin 2/2 të ligjit nr. 9831, sipas të cilit dëmshpërblimi i deritanishëm nuk përjashton marrjen e masave të tjera të njëkohshme apo të mëvonshme në dobi të ish të dënuarve politikë.

ii) Kërkuarët pretendojnë gjithashtu papajteshmërinë e nenit 1, paragrafi 2, të ligjit objekt kërkesë me Kushtetutën, në pjesën që e kushtëzoi dëmshpërblimin financiar për personat e internuar ose të dëbuar, me gjetjen e dokumenteve të krijuar si burim arkivor para datës 1.11.1991 dhe që vërtetojnë humbjen e jetës apo vuajtjen në internim ose dëbim. Sipas tyre, ky kushtëzim sjell si pasojë mohimin e dëmshpërblimit, përderisa dihet që ky burim arkivor mungon.

Gjykata konstaton se ligji i ri nr.10111, ka ndryshuar nenin 3 të ligjit të mëparshëm, nen në të cilin përcaktohet kuptimi i dënimit penal të padrejtë. Sipas nenit 3, elementet që përcaktojnë dënimin penal të padrejtë për vepra penale politike janë lloji i dënimit të kryer dhe aktet me të cilat provohen këto dënime. Ndryshimi i bërë në këtë nen konsiston në shtimin e shkronjës “f”, e cila parashikon “... akti administrativ apo dokumenti zyrtar që provon internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba”. Si rezultat i ndryshimit në normën ligjore, rrethi i akteve me të cilat provohet dënimi penal i padrejtë, përfshin edhe aktin administrativ dhe dokumentin zyrtar. Në këtë mënyrë, ligji objekt shqyrtimi, i ndryshuar, parashikon si dokument provues të internimit apo dëbimit jo vetëm ato të krijuara si burim arkivor para datës 1.11.1991 (neni 1, paragrafi i dytë), por dhe çdo akt tjetër administrativ apo dokument zyrtar që provon këtë fakt (neni 3). Sa më sipër, statusi i të internuarit apo të dëbuarit, për efekt të dëmshpërblimit financiar, provohet me çdo akt administrativ apo dokument zyrtar të nxjerrë nga organi kompetent, pavarësisht kohës së krijimit të burimit arkivor.

iii) Një pretendim tjetër i kërkuesve ka të bëjë me faktin se një pjesë e familjarëve të viktimave të ekzekutuara apo pushkatuara me vendime penale të gjykatave janë përjashtuar nga dëmshpërblimi financiar, pasi neni 8 i ligjit nr.9831, objekt shqyrtimi, ka ngushtuar rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të tyre, duke përfshirë vetëm paraardhësit, bashkëshorten, fëmija/fëmijët.

Gjykata konstaton se përmbajtja e nenit 8 është ndryshuar me nenin 5 të ligjit nr.10111 dhe ka përfshirë në rrethin e familjarëve që përfitojnë dëmshpërblim financiar, në kuptim të ligjit, paraardhësit, bashkëshorten, fëmija/fëmijët, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish të dënuarit politik, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave.

Gjykata vlerëson se ndryshimet e mësipërme ligjore i kanë dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesve, duke zgjeruar rrethin e familjarëve që përfitojnë dëmshpërblim financiar, pasi kanë shtuar pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish të dënuarit politik, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave.

iv) Kërkuesit kanë pretenduar edhe mungesën e kriterëve për ndarjen e fondit të dëmshpërblimeve të parashikuara në nenin 12. Gjykata konstaton se përmbajtja e nenit të kundërshtuar është ndryshuar me nenin 6 të ligjit nr.10111 dhe si rezultat i ndryshimi të kësaj norme ligjore, fondet nuk do të ndahen më në mënyrë të barabartë, por sipas një kriteri tjetër, atij proporcional.

Nga analiza e mësipërme, Gjykata vlerëson, se për të gjitha pretendimet në lidhje me nenin 1, 8 dhe 12, për të cilat ligji i ri ka sjellë shtesa dhe ndryshime, çështja mbetet pa objekt, e për rrjedhojë, duhet të pushohet.

IV

Lidhur me pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimeve kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit

1. Kërkuesit pretendojnë se ligji objekt kundërshtimi cenon parimet kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit. Gjykata, kushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara e vlerëson pasi të ketë sqaruar kuptimin dhe përmbajtjen e parimeve kushtetuese të referuara nga kërkuesit.

2. Siguria juridike, si koncept kushtetues i trajtuar disa herë nga praktika e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, përbën një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Në këtë pikëpamje, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë nëpërmjet akteve të veta me hollësi të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Vetëm ato të drejta, të cilat janë parashikuar si shprehimisht të pakufizueshme, nuk është e mundur të preken nga ligjvënësi (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008*).

3. Barazia përpara ligjit kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk parakupton zgjidhje të njëjlojta për individë apo kategori subjektësh të cilët ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme.

Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*Shih vendimin nr.19, datë 9.7.2009*).

4. Një nga pretendimet e kërkuesve është se ligji nuk trajton dëmshpërblimin e personave që janë të sëmurë psikikë për shkak të përndjekjes.

Gjykata konstaton se ligji objekt shqyrtimi, i ndryshuar, nuk përfshin kategorinë e të sëmurëve psikikë në rrethin e subjekteve që përfitojnë dëmshpërblim financiar. Nga ana tjetër, ligji

nr.9831, i ndryshuar, nuk ka shfuqizuar nenin 3, shkronja “a” të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Mbi statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, që parashikon të sëmuret psikikë për shkak të përndjekjes, si një nga pesë kategoritë e të përndjekurve politikë. Ligjvënësi, në nenin 2/2 të ligjit objekt shqyrtimi ka përcaktuar se: “Dëmshpërblimi financiar, sipas këtij ligji nuk përjashton marrjen e masave të tjera të njëkohshme ose të mëvonshme, ligjore apo administrative, në dobi të të persekutuarve e të dënuarve politikë, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese, apo krijimit të kushteve favorizuese për riintergrimin shoqëror të tyre”.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se, në vështrim të standardeve kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë në ligj, nuk evidentohet qëllimi i ligjvënësit për cenimin e këtyre parimeve.

5. Kërkuesit pretendojnë gjithashtu se ligji nuk duhet t’i kishte filluar efektet për dëmshpërblim financiar që nga 30.11.1944, por nga vitit 1941, pasi fusha e veprimit të ligjit nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist” në fuqi shtrihet nga data 08.11.1941 deri në datë 22.03.1992. Sipas tyre, ky kufizim në kohë cenon parimin e sigurisë juridike, sepse subjektet që e kanë përfituar statusin e të përndjekurit me ligjin e mëparshëm, nuk mund të përfitojnë dëmshpërblimin me ligjin objekt shqyrtimi.

Gjykata vëren se kërkuesit nuk paraqitën argumente kushtetuese për të provuar cenimin e parimit të sigurisë juridike, në kushtet kur krahasimi bëhet për dy periudha me rrethana të ndryshme historike dhe kur është në vlerësimin e ligjvënësit të përcaktojë periudhën kohore kur do të jepet dëmshpërblimi.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkesa në lidhje me këtë pretendim duhet të rrëzohet.

6. Kërkuesit pretendojnë gjithashtu se neni 6, pikat “b” dhe “c”, të ligjit objekt shqyrtimi i trajton të internuarit dhe të dëbuarit në mënyrë të diferencuar, në periudha të ndryshme kohore.

Gjykata konstaton se neni 6, pika “b” e ligjit objekt kundërshtimi përcakton se personat që kanë vuajtur internim në kampe me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, përfitojnë dëmshpërblim në masën 1000 (njëmijë) lekë në ditë. Përsa i përket të internuarve e të dëbuarve të tjerë (neni 6 pika “c”), ligjvënësi ka autorizuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e një skeme pensioni. Nga përmbajtja e kësaj norme ligjore rezulton se për personat që kanë vuajtur internim në kampe me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954 parashikohet një masë konkrete dëmshpërblimi, ndërsa për të internuarit dhe të dëbuarit e tjerë, do të përcaktohet një skeme pensioni nga Këshilli i Ministrave.

Gjykata vlerëson se ligjvënësi, në përputhje me nenin 118, pika 2 të Kushtetutës, ka ngarkuar Këshillin e Ministrave të hartojë skemën e pensionit dhe të përcaktojë trajtimin financiar të të internuarve e të dëbuarve të tjerë, ashtu siç ka vepruar dhe për dëmshpërblimin e familjarëve të viktimave të ekzekutuara pa gjyq. Përcaktimi i masës së dëmshpërblimit të të internuarve dhe të dëbuarve politikë i takon sferës së rezervës relative të ligjit, prandaj Kuvendi nuk ka pengesë kushtetuese që këtë problem t’ia delegojë për rregullim Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, Gjykata vëren se neni 6, për efekt të dëmshpërblimit, i ndan të internuarit në dy grupe: (i) personat që kanë vuajtur internimin në kamp me rrethim me tela me gjemba, deri në vitin 1954, dhe (ii) të internuarit ose të dëbuarit e tjerë. Nga formulimi i normës ligjore rezulton se kriteri dallues i kategorive të mësipërme është lloji i kampeve të vuajtjes së internimit. Nisur nga ky fakt dhe në vështrim të parimit të barazisë përpara ligjit, Gjykata rithekson se, kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, mund të bëhen trajtime të ndryshme.

Në këto kushte Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë është i pabazuar, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

7. Në lidhje me pretendimet e kërkuesve se disa nga kushtet dhe kriteret për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, të përcaktuara në disa nene të ligjit objekt kundërshtimi, sjellin si pasojë mospërfitimin e kësaj të drejte, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk janë ngritur në nivel kushtetues, por janë të natyrës administrative dhe teknike.

Për rrjedhojë, kërkesa në lidhje me pretendimet e mësipërme duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “a” të Kushtetutës, nenit 134, pika 1, shkronja “f”, nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 1, 8 dhe 12 të Ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”

- Rrëzimin e kërkesës së kërkuarve në lidhje me pjesën tjetër të ligjit objekt shqyrtimi.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar) Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 2.3.2010

Doli nga shtypi më 3.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë